



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA"
FAKULTETI AGROBIZNESIT

Programi: Menaxhim i mjedisit (MSc)

Emërtimi i programit të studimit:	Menaxhim i mjedisit
Niveli i kualifikimit sipas KKK:	Arsimi i lartë – Cikli i dytë i Bolonjës (Master) MSc. Niveli 7 sipas KKK
Numri ECTS kredive:	120
Grada akademike (kualifikimi i fituar):	Master i shkencës në Menaxhim të mjedisit (MSc)
Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite / 4 semestra
Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit:	Qëllimi i programit të studimit - Qëllimi i programit "Menaxhim Mjedisit (MSc)" është të përgatisë profesionistë të aftë për të menaxhuar, mbrojtur dhe zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme mjedisin, duke kombinuar njohuritë shkencore me aftësitë praktike të nevojshme për vendimmarrje efektive në sektorin publik dhe privat. - Programi synon të zhvillojë ekspertë që janë të gatshëm të analizojnë, planifikojnë dhe zbatojnë politika, strategji dhe projekte për menaxhimin e resurseve natyrore dhe mbrojtjen e ekosistemeve, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të qëndrueshmërisë. Objektivat e programit të studimit: Programi ka për objektiv që pas përfundimit të studimeve, studenti të jetë në gjendje të: - Kuptojë në mënyrë të thelluar konceptet, parimet dhe proceset që lidhen me menaxhimin e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm; - Aplikojë metoda shkencore dhe teknologjike për monitorimin, analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve mjedisore; - Hartojë dhe zbatojë plane dhe projekte për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin racional të burimeve natyrore; - Përdorë instrumente të politikave mjedisore dhe legjislacionit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar; - Integrojnë njohuritë ekonomike, ekologjike dhe menaxheriale në zhvillimin e strategjive të qëndrueshme të menaxhimit; - Zhvillojë afësi kërkimore për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve komplekse mjedisore;

	- Komunikojë në mënyrë profesionale me institucione, komunitete dhe aktorë të tjerë në proceset e vendimmarrjes për mjedisin; - Kontribuojë në hartimin e politikave publike dhe planeve zhvillimore që promovojnë ruajtjen e biodiversitetit dhe uljen e ndotjes
Rezultatet e pritshme të të nxënit:	Rezultatet e pritura të të nxënit të programit Menaxhim Mjedisit MSc: Studenti pas përfundimit të këtij programi të studimi do të jetë në gjendje: - Të demonstrojë njohuri të avancuara në fushën e shkencave natyrore, sociale dhe njerëzore në analizën e çështjeve mjedisore dhe strategjive të menaxhimit; - Të identifikojë dhe analizojë në mënyrë kritike ndikimin e burimeve antropogjene dhe burimeve të tjera të ndotjes në ajër, ujë dhe tokë; - Të përdorë njohuritë teorike dhe të aplikuara për të vlerësuar dhe rekomanduar strategjitë e menaxhimit dhe zgjidhjet për problemet mjedisore; - Të demonstrojë aftësi për të zhvilluar dhe zbatuar politika dhe legjislacion kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit; - Identifikimi dhe aplikimi i mjeteve, teknikave dhe teknologjive adekuate për të analizuar çështjet mjedisore; - Të vlerësojë (vlerësojë) biodiversitetin dhe të zbatojë masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tij; - Të demonstrojë njohuri për parimet dhe metodat e kërkimit për të përfunduar një projekt kërkimor; - Të komunikojë çështjet e menaxhimit mjedisor në formë të shkruar, gojore dhe vizuale;
Procedurat e mësimdhënies:	Procesi i mësimdhënies në programin “Menaxhim i mjedisit” zhvillohet në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë dhe me parimet e sistemit të Bolonjës, duke vendosur studentin në qendër të procesit të të nxënit. Qëllimi kryesor është të sigurohet që çdo student të zhvillojë kompetenca profesionale, shkencore dhe praktike të nevojshme për tregun modern të punës. 1. Parimet bazë të mësimdhënies Mësimdhënia bazohet në këto parime kryesore: - Përdorimi i metodave interaktive dhe gjithëpërfshirëse; - Integrimi i pjesës teorike me atë praktike (raporti 60% teori / 40% praktikë); - Nxitja e mendimit kritik dhe kreativ; - Zhvillimi i kompetencave kërkimore dhe të zgjidhjes së problemeve; - Bashkëpunimi aktiv midis stafit akademik dhe studentëve. 2. Format dhe metodat e mësimdhënies Procesi mësimor realizohet përmes një kombinimi të formave tradicionale dhe moderne të mësimdhënies: Ligjërata teorike, ku prezantohen konceptet bazë dhe kornizat shkencore; Ushtrime praktike në laboratorë, forma eksperimentale dhe biznese partnere të agrobiznesit;

	• Seminare dhe prezantime ku studentët zhvillojnë aftësi komunikimi dhe analize; • Punë në terren, për studime mjedisore dhe monitorim ekologjik; • Projektet kërkimore individuale apo në grup, të orientuara drejt problemeve reale; • Studime rasti dhe simulime, për të zhvilluar vendimmarrjen dhe zbatimin praktik të teorisë; • Mentorim dhe konsultime individuale për mbështetje akademike dhe profesionale. 3. Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie Në përputhje me zhvillimet bashkëkohore, përdoren platformat digjitale dhe sistemet elektronike të menaxhimit të mësimi (SMU / SEMS) për: • publikimin e materialeve mësimore, syllabus-it dhe orareve; • komunikimin ndërmjet studentëve dhe profesorëve; • dorëzimin dhe vlerësimin e punimeve; • ndjekjen e pjesëmarrjes dhe rezultateve të studentëve. Gjithashtu, përfshihen simulime mjedisore digjitale, softuerë analitikë dhe platforma kërkimore që ndihmojnë studentët në hulumtime shkencore dhe analiza laboratorike. 4. Vlerësimi dhe përmirësimi i procesit të mësimdhënies Cilësia e mësimdhënies vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme përmes: • pyetësorëve të studentëve në fund të çdo semestri; • vlerësimeve nga koordinatori i cilësisë dhe dekanati; • raportimeve periodike të profesorëve mbi ecurinë e mësimi; • analizës së performancës së studentëve në provime dhe projekte; takimeve të rregullta ndërmjet stafit akademik dhe administratës për përmirësim të metodave didaktike.
Procedurat dhe llojet e vlerësimit të përdorura (notimi i studentëve):	Sipas nenit 104, 105, 106 të Statutit të UHZ, vlerësimi përfundimtar i studentëve bëhet me anë të testimit me shkrim dhe me gojë. • Pjesa e vlerësimit dhe notimit të studentëve varet nga lënda dhe kriteret e përdorura në mënyrë individuale nga mësimdhënësi i lëndës. • Studenti vlerësohet gjatë gjithë semestrit përmes testeve, punimeve seminareve, pjesëmarrjeve në projekte, konferenca shkencore, etj. • Metodatat e vlerësimit përcaktohen në syllabuse të secilës lëndë mësimore veç e veç në kuadër të programit, Një shembull vlerësimi është si më poshtë: • Pjesëmarrja aktive në mësim..... 10 për qind • Detyrat, ushtrimet. 10 për qind • Testi i parë.....20 për qind • Testi i dytë. 20 për qind • Provimi përfundimtar. 40 për qind • Total 100% Një shembull i kriterit të notimit është si në vijim: • 0-50.99% (5) • 51-60.99% (6)

	• 61-70.99% (7) • 71-80.99% (8) • 81-90.99% (9) • 91-100% (10)
Ndarja e lëndëve të programit sipas rëndësisë:	
a). Lëndë të përgjithshme:	Viti I – semestri i parë 1. Menaxhimit i integruar i burimeve ujore II 2. Menaxhimi i mbeturinave 3. Konservimi (ruajtja) e biodiversitetit 4. Zhvillimi i qëndrueshëm Viti I – semestri i dytë 5. Menaxhimi i përdorimit të tokës 6. Analiza e te dhënave mjedisore 7. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor 8. Ndërmarrësi e gjelbër Viti II – semestri i tretë 9. Menaxhim i kualitetit të ajrit 10. GIS 11. Metodologjia e hulumtimit shkencor 12. Legjislacioni i avancuar mjedisor 13. Journal Club
b) Lëndë zgjedhore:	Viti I – semestri i parë 14. Menaxhim i zonave të mbrojtura 15. Ekologji e pyjeve 16. Ekonomia e Mjedisit 17. Analiza e kost-benifitit në vlerësimin mjedisor Viti I – semestri i dytë 18. Energjia dhe ndryshimet klimatike 19. Planifikim hapësinor 20. Ekonomia e mjedisit dhe menaxhimi i resurseve natyrore Viti II – semestri i tretë 21. Internship 22. Auditimi Mjedisor 23. Bazat mikroekonomike për menaxherët e mjedisit Viti II – semestri katër 24. Punimi i temës master
Perspektiva e studentit – Mundësitë e punësimit pas diplomimit në Menaxhim Mjedisori (Msc)	Pas përfundimit të studimeve në Menaxhim Mjedisori (MSc), studentët zotërojnë njohuri të thelluara mbi menaxhimin e burimeve natyrore, zhvillimin e projekteve mjedisore, vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe politikat e qëndrueshme të mjedisit. Kjo i bën ata të aftë për të punuar në një gamë të gjerë institucione dhe sektorësh, si: • Institucione publike dhe qeveritare: Agjenci mjedisore, ministri të mjedisit, komunat, në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, ujit, ajrit dhe burimeve natyrore. • Organizata joqeveritare (OJQ): Organizata lokale dhe ndërkombëtare që operojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe edukimit ambientat. • Sektori privat: Kompani që kërkojnë ekspertizë për menaxhimin e mjedisit, auditime mjedisore, certifikime ekologjike, trajtimin e mbetjeve dhe raportimin e

	qëndrueshmërisë. • Institucione kërkimore dhe akademike: Qendra kërkimore, universitete dhe laboratorë që zhvillojnë studime mbi ndikimet mjedisore dhe teknologjitë e qëndrueshme. • Konsulencë dhe shërbime profesionale: Konsulentë për projekte mjedisore, planifikim të qëndrueshëm urban dhe analiza të ndikimit ambiental. Studentët pas diplomimit janë të përgatitur për të kontribuar në zbatimin e politikave mjedisore, përmirësimin e performancës së organizatave në aspektin e mjedisit dhe zhvillimin e projekteve që promovojnë qëndrueshmërinë.
--	--

Kostoja e shpenzimeve:

Lloji i shpenzimit	Përshkrimi	Vlerë e përafërt (€/vit)
Librat dhe materialet mësimore	Librat, artikujt shkencorë, softuerë mësimor	100 – 500
Pajisjet laboratorike/fushore	Instrumente për matje mjedisore, material laboratorik	250 – 500
Transporti dhe udhëtimet	Udhëtime për vizita studimore, ekskursionë, praktika	100 – 500
Akomodimi dhe ushqimi	Shpenzime për qëndrim dhe ushqim gjatë praktikave apo projekteve në terren	500 – 800
Shpenzime të tjera personale	Shëndet, komunikim, internet, material shtesë	100 – 200